




KOSOVA KA 1.58 MILION
BANORË REZIDENTË

FAQE 3



Agjencia e Statistikave e Kosovës ka paraqitur sot rezultatet paraprake të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë. Sipas këtyre rezultateve, Republika e Kosovës ka 1 586 659 banorë, prej të cilëve 795 046 meshkuj (50.1 %) dhe 791 614 femra (49.9 %). Mosha mesatare del të jetë 34.8 vjet. Ndërkohë që regjistrimi i mërgatës po vazhdon. Aktualisht në diasporë janë regjistruar rreth 600 000 banorë

OSMANI NË MESIN E LIDERËVE BOTËRORË:
HERA E PARË QË KOSOVA U PËRFSHI NË NJË
SAMIT TË NATO-S

F.7



BSPK-ja: TEMPERATURAT JANË EKSTREME,
PUNËTORËT TË PAMBROJTUR

F.6

AKTUALE



**ZELENSKY: MARRËVESHJA
PËR UKRAINËN, ARRITJE
E RËNDËSISHME**

F.2

**QEVERIA MBRON PROJEKTLIGJIN
PËR KPM-në**

F.7

**VLERËSOHET PUNA E STACIONEVE
POLICORE NË FERIZAJ, KAÇANIK,
SHTIME, SHTËRPCË DHE HAN TË
ELEZIT**

F.6

EKONOMI



**TRAJNIMET PËR SIGURINË NË
PUNË, PËR DISA TË PADËGJUARA**

F.3

**AKB-ja: 57 % E QYTETARËVE DO
TË SHKOJNË NË PUSHIME VERORE,
GJYSMA E TYRE DO TË MARRIN
KREDI APO BORXH**

F.3

SPORT



**LARGOHET TRAJNERI BRANDO, VJEN
SULMUESI FITON HAJDARI**

F.10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepcisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji
BIZNESI

www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Marrëveshja për Ukrainën, arritje e rëndësishme

UASHINGTON, 12 KORRIK - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e mirëpriti marrëveshjen e re për përkrahjen afatgjatë të Ukrainës, e cila u finalizua në samitin e NATO-s në Uashington këtë javë, duke e cilësuar “arritje të rëndësishme” për Kievin dhe të tjerët. Ai e lavdëroi leadershipin amerikan për “veprimet e tyre vendimtare” për të garantuar siguri për Ukrainën.

Përmes marrëveshjes, Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe mbi 20 vende të tjera u zotuan se do të ndihmojnë për ta mbrojtur Ukrainën. Marrëveshja u paraqit nga presidenti amerikan Joe Biden në një konferencë për medie përkrah liderëve të tjerë të NATO-s dhe



Zelenskyt në përfundim të samitit më 11 korrik. “Kjo marrëveshje ukrainase, të cilën ne po e finalizojmë, i çon marrëdhëniet tona në një nivel të ri. Kjo është një arritje e madhe për Ukrainën dhe për të gjithë ne”, tha Zelensky. “E

falënderoj presidentin Biden për leadershipin e tij dhe përpjekjet për t’u siguruar që bashkëpunimi ynë për sigurinë të jetë plot veprime vendimtare”, theksoi Zelensky. Ai tha se marrëveshja e ka ndihmuar Kievin të marrë sisteme tejet të

rëndësishme të mbrojtjes ajrore, për ta ndihmuar ta luftojë pushtimin tashmë mbi dyvjeçar rus.

Njëzet e katër liderë të NATO-s dhe Ukraina e miratuan marrëveshjen në kuadër të përforsimit të mbrojtjes së Ukrainës dhe përkushtimeve të tjera.

Liderët u zotuan për t’u takuar “shpejt dhe bashkërisht” në nivel të lartë, në rast të ndonjë sulmi nga Rusia kundër Ukrainës në të ardhmen, pas përfundimit të konfliktit të tanishëm.

Bideni e ka quajtur marrëveshjen “pjesë qendrore” të një “ure” në rrugën e Ukrainës drejt NATO-s. “Sot këtu, me të gjithë këta njerëz të rëndësishëm mbrapa meje, ne po e ndërmarrim një hap tjetër të

rëndësishëm në mbështetjen tonë të përbashkët për Ukrainën”, tha Bideni. “Vitin e kaluar vendet e G7-s... nënshkruan një deklaratë për ta mbrojtur Ukrainën për kohë të gjatë jo vetëm gjatë luftës, por edhe më pas, pasi të ketë fituar ajo. Edhe 25 vende të tjera iu bashkuan atyre shpejt dhe u zotuan për të negociuar dhe për të nënshkruar marrëveshje dypalëshe të sigurisë me Ukrainën”, shtoi ai.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha në samit se aleanca po “i vë gurthemelet për triumfin e Ukrainës” në përpjekjet e saj për ta mbrojtur veten kundër Rusisë dhe se aleanca “nuk mund dhe nuk do të lejojë të ndodhë një gjë e tillë përsëri”.

Orbani takohet me Trumpin pas samitit të NATO-s

UASHINGTON, 12 KORRIK - Kryeministri nationalist i Hungarisë, Viktor Orban, u takua në Florida me ish-presidentin amerikan Donald Trump pas përfundimit të samitit të NATO-s në Uashington.

Takimi me Trumpin ka të ngjarë t’i shqetësojë edhe më shumë aleatët e Budapestit, teksa Orbani zemëroi homologët e tij evropianë pasi u takua me presidentin rus Vladimir Putin javën e kaluar.

Orbani, politikan i krahut të djathtë, shteti i të cilit gjatë këtij muaji mori udhëheqjen e Presidencës së Bashkimit Evropian, ka qenë mbështetës i zëshëm i Trumpit dhe u takua me kandidatin republikan për

president në mars. “Diskutuam për mënyrat se si të arrijmë paqe”, tha Orbani përmes një postimi në rrjetet sociale, ku publikoi edhe një fotografi të takimit me Trumpin. “Lajmi i mirë i ditës: ai do ta zgjidhë këtë çështje”.

Trumpi iu përgjigj postimit të Orbani duke shkruar në rrjetin social “Truth Social”: “Faleminderit Viktor! Duhet të ketë paqe dhe shpejt. Shumë njerëz kanë vdekur në luftën që kurrë nuk është dashur të nisë”. Orbani nxiti kritika nga BE-ja pasi shkoi në Moskë për t’u takuar me Putinin. Lideri hungarez e përshkroi vizitën e tij si “mision për paqe” sa i përket luftës në Ukrainë.



Vizita e tij në Rusi u realizua pas një vizite që ai zhvilloi në Kiev, ku u takua me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky.

Blloku evropian, prej 27 anëtarësh, ka dënuar pushtimin rus të Ukrainës dhe ka vendosur sanksione të paprecedenta ndaj

Moskës.

Lideri hungarez dukej i izoluar gjatë samitit të NATO-s në Uashington dhe nuk foli shumë për mediet. “Viktor Orban nuk ka mandat nga aleanca, as nga BE-ja, të zhvillojë ndonjë formë të negociatave”, tha presidenti i Finlandës, Alexander Stubb, gjatë samitit të NATO-s. “Ai mund ta bëjë këtë personalisht, por unë nuk pajtohem aspak me një gjë të tillë. Thjesht, nuk shoh arsye”.

Orbani, sikurse Trumpi, ka shprehur skepticizëm lidhur me rolin që po luajnë shtetet e NATO-s në mbështetje të Ukrainës dhe ka refuzuar t’i dërgojë armë Kievit, duke thënë se një gjë e tillë do ta përshkallëzonte konfliktin.

BE-ja: ‘X’ po i mashtron përdoruesit me llogaritë e verifikuara

BRUKSEL, 12 KORRIK - Platforma “X” e miliardit Elon Musk po i mashtron përdoruesit me llogaritë e verifikuara dhe po shkel rregullat e përmbajtjes të Bashkimit Evropian, tha Brukseli më 12 korrik, njoftim që mund të çojë në gjoba të majme.

Rregullatorët e BE-së nuk janë të kënaqur me sistemin e verifikimit të llogarive në “X”, në pronësi të Muskut, pasi që kushdo që ka abonim premium mund ta verifikojë llogarinë. Më herët, para se Musk ta blinte platformën - që paraprakisht quhej “Twitter” - llogaritë e verifikuara ishin të rezervuara për liderët, kompanitë dhe gazetarët, pas miratimit.

Vërejtja zyrtare ndaj platformës X është e para që bëhet sipas Aktit të shërbimeve digjitale (DSA), një ligj



që detyron kompanitë digjitale të bëjnë më shumë për ta kontrolluar përmbajtjen online. Vërejtja u bë pasi rregullatorët nisën një hetim dhjetorin e vitit të kaluar.

“X” bëhet kompania e tretë që përballlet me vërejtje të BE-së për shkelje të rregullave të reja, pasi

Brukseli paralajmëroi kompanitë Apple dhe Meta që ta ndryshojnë mënyrën se si funksionojnë ose do të përballen me gjoba masive për shkelje të ligjit të dytë të njohur si Akti i tregjeve digjitale (DMA).

Musk e bleu platformën e medieve sociale Twitter në tetor të vitit 2022

dhe më pasi ai ndryshoi emrin. Por, planet e tij për kompaninë X e kanë përplasur me BE-në, pasi blloku dëshiron që kompanitë e mëdha të teknologjisë të bëjnë më shumë për t’i mbrojtur përdoruesit online dhe ta rrisin konkurrencën në sferën digjitale.

Tani Komisioni Evropian në vlerësimin fillestar për platformën “X” tha se kompania “po shkel” DSA-në, duke argumentuar se rrjeti social “po mashtron” përdoruesit me rregullat për verifikimin e llogarive. “Pasi që kushdo mund të abonohet dhe ta marrë statusin e ‘verifikimit’, kjo ka efekte negative në aftësinë e përdoruesve që të marrin vendime të lira dhe të mirinformuara për autenticitetin e llogarive dhe përmbajtjes me të cilët ata ndërveprojnë”, u tha në

deklaratë. “Ka dëshmi se një gjë e tillë motivon aktorët dashakeq që të abuzojnë me ‘llogaritë e verifikuara’ për t’i mashtruar përdoruesit”, u tha në deklaratë.

KE-ja, po ashtu, akuzon kompaninë X se ka dështuar t’i respektojë rregullat sa i përket transparencës së reklamimit, pasi kompania nuk ofron një bazë të të dhënave “ku mund të bëhen kërkime dhe që është e besueshme”. Po ashtu, blloku thotë se kompania e Muskut nuk u ka dhënë qasje hulumtuesve në të dhëna publike.

“X” tani ka të drejtë të mbrohet, por nëse vlerësimi ynë konfirmohet, ne do të vendosim gjoba dhe do të kërkojmë ndryshime të mëdha”, tha zyrtari i lartë i BE-së për fushën digjitale, Thierry Breton.

Doarsa Kica-Xhelili: LDK-ja nuk bën koalicion me kryeministër Kurtin

PRISHTINË, 12 KORRIK - Deputetja e LDK-së, Doarsa Kica-Xhelili, ka thënë se partia e saj nuk ka vija të kuqe me asnjë parti, por ka theksuar se nuk bëjnë koalicion nëse kryeministër propozohet të jetë Albin Kurti. Ajo është shprehur se LDK-ja pas zgjedhjeve do ta shohë pozicionin e saj. "LDK-ja nuk ka vija të kuqe me askënd. Dukshëm vijat e kuqe

ndër vite janë shndërruar në të kaltra e të gjelbra. LDK-ja nuk bën koalicion me kryeministër Albin Kurtin. Nuk bën koalicion nëse ai është kryeministër. LDK-ja do ta ofertojë iniciativën e vet politike dhe do të shikojë se ku e pozicionon qytetari, pastaj do të shohim e bëjmë", ka deklaruar ajo në "RTV Dukagjini". Kica-Xhelili ka drejtuar

kritika ndaj Kurtit, për të cilin ka thënë se nuk e di as çka është Kushtetuta. "E ki kryeministrin e Kosovës që aktin më të lartë e ka Kushtetutën, idenë më të vogël nuk e ka çka është Kushtetuta... s'e ka idenë e ndarjes së pushteteve, apo nuk i konvenon demokracia si sistem. Kryeministrit nuk i konvenon demokracia si sistem", ka theksuar ajo.



PIPS: 2023-a, vit shumë sfidues për Kosovën në arenën ndërkombëtare

PRISHTINË, 12 KORRIK - Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), në kuadër të Programit për Analizë të Politikës së Jashtme (PAPJ), ka publikuar të premten raportin vjetor, të 5-tin me radhë, me titull "Vjetari i politikës së jashtme (2023). Raporti ofron një analizë të shkurtër të politikës së jashtme të Kosovës përgjatë vitit 2023 deri më 15 shkurt 2024. Qëllimi i këtij raporti është t'i dokumentojë zhvillimet, sfidat dhe objektivat strategjike të Kosovës në lidhje me politikën e jashtme. Të dhënat e mbledhura përfshijnë deklaratat zyrtare të qeverisë, të dhënat e takimeve diplomatike dhe analizat e angazhimeve ndërkombëtare. Kapitujt flasin për marrëdhëniet bilaterale apo dypalëshe, njohjen

diplomatike dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, integrimin euroatlantik, dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dhe performancën e MPJD-së së Kosovës gjatë vitit 2023. Gjetjet kryesore tregojnë se ka qenë një vit shumë sfidues për Kosovën në arenën ndërkombëtare, i karakterizuar me një proces të komplikuar të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, acarime të marrëdhënieve me aleatët strategjikë kryesorë, masat "ndëshkuese" nga Bashkimi Evropian, sfidat në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe moslëvizja në sferën e njohjeve të reja, si dhe sfidat e brendshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.



Kurti takohet me rektorin dhe deputetin e Hamburgut, flasin për mundësitë e bashkëpunimit në arsim



PRISHTINË, 12 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të premten në ndërtesën e qeverisë rektorin e Fachhochschule Flensburg dhe deputetin e Parlamentit të Hamburgut, Sven Tode. Takimi filloi me urimin e kryeministrit për mirëseardhje në Kosovë dhe për interesimin e Todes në fushën e arsimit në Kosovë. Kryeministri Kurti e njoftoi atë mbi arritjet e qeverisë në fushën e arsimit.

Gjatë bashkëbisedimit u diskutua edhe rreth marrëdhënieve bilaterale në këtë drejtim, bashkëpunimin akademik dhe për mundësitë dhe potencialin që paraqet mërgata jonë në Gjermani për fuqizimin edhe më tej të marrëdhënieve tona. Kryeministri Kurti theksoi se buxheti për sektorin e arsimit është rritur 26 %, kurse studimet universitare janë pa pagesë për studentët. Sven Tode shprehu mirënjohjen e

tij për mikpritjen dhe e përgëzoi Qeverinë e Kosovës për përparimet e bëra në fushën e arsimit. Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, Tode do t'i vizitojë disa universitete dhe shkolla për t'i parë nga afër zhvillimet dhe mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm. Në Hamburg ai është në kontakt të vazhdueshëm me studentët shqiptarë dhe synon t'i forcojë lidhjet akademike dhe kulturore ndërmjet dy vendeve.


AKB-ja: 57 % të qytetarëve do të shkojnë në pushime verore, gjysma e tyre do të marrin kredi apo borxh

PRISHTINË, 12 KORRIK - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka bërë një studim hulumtues se sa qytetarë të Kosovës do të shkojnë këtë vit në pushime verore, ku i marrin paratë dhe ku do të shkojnë. Nga ky studim rezulton se 57 % të qytetarëve të Kosovës do të shkojnë në pushime verore, 24 % as që kanë në plan pushimin veror, 13 % ndoshta, kurse 6

% nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje. Në pyetjen tjetër ku do t'i marrin paratë për pushime, rezulton se 40 % nga kursimet, 30 % nga kreditë, 25 % nga huazimet, 5 % nuk janë përgjigjur. Agim Shahini, kryetar i AKB-së, thotë se nga kjo mund të konstatojmë se vetëm 57 % e qytetarëve të Kosovës e kanë mundësinë të shkojnë në pushime,

kurse 43 % nuk e kanë këtë mundësi për pushime edhe pse kanë nevojë, kurse nga 57 % që e kanë këtë mundësi, 55 % e tyre shkojnë me paratë nga burimet e borxhit dhe huazimet. AKB-ja ka bërë me dije se në ditët e ardhshme do të publikohet pjesa e dytë se ku po shkojnë për pushime kosovarët në verën 2024 dhe sa para do t'i harxhojnë.





Kosova ka 1.58 milion banorë rezidentë

Agjencia e Statistikave e Kosovës ka paraqitur sot rezultatet paraprake të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë. Sipas këtyre rezultateve, Republika e Kosovës ka 1 586 659 banorë, prej të cilëve 795 046 meshkuj (50.1 %) dhe 791 614 femra (49.9 %). Mosha mesatare del të jetë 34.8 vjet. Ndërkohë që regjistrimi i mërgatës po vazhdon. Aktualisht në diasporë janë regjistruar rreth 600 000

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës ka publikuar të dhënat paraprake të regjistrimit të popullsisë dhe, sipas këtyre të dhënave, Kosova ka 1 586 659 banorë rezidentë. Nga ky numër, 795 046 janë meshkuj dhe 791 614 femra. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të ASK-së, Avni Kastrati, tha se të dhënat përfundimtare të regjistrimit të popullsisë planifikohen të publikohen në fund të vitit. Ai tha se nuk pritet të ketë dallime të mëdha nga të dhënat paraprake, duke theksuar se, sipas praktikave edhe në vendet e rajonit, ndryshimi mund të jetë nga 1 deri në 3 për qind. Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave u zhvillua në të gjitha komunat e Kosovës nga 5 prilli deri më 24 maj. Kastrati tha se në këto të dhëna

nuk përfshihet numri i pjesëtarëve të diasporës, pasi procesi i regjistrimit të tyre ende po vazhdon. Aktualisht, sipas tij, në diasporë janë regjistruar rreth 600 000. Sa i përket regjistrimit të komunitetit serb, ASK tha se procesi u bojkotua në masë të madhe në katër komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Ndërkaq, serbët që jetojnë në jug të Lumit Ibër kanë marrë pjesë në procesin e regjistrimit. Sipas të dhënave paraprake, në Mitrovicë të Veriut janë regjistruar 2 300 persona, në Zvečan 435, në Zubin Potok 758 dhe në Leposaviq 3 207. Ligji për Regjistrimin e Popullsisë parasheh gjoba prej 30 deri në 2 000 eurosh për personat që refuzojnë të regjistrohen. Gjohat janë edhe më të mëdha, deri në 20 000 euro për biznese. ASK tha se mosha mesatare në Kosovë është rritur. Më 2011 mosha mesatare në vend llogaritej të jetë rreth 30 vjeç,

ndërkaq tani është 34.32. Gjatë prezantimit të të dhënave u tha se nëntë komuna kanë pasur rritje të popullsisë, ndërkaq 29 të tjera kanë pasur rënie. Fushë-Kosova prin me rritjen më të madhe prej rreth 84-përqindësh, ndërkaq rënie më të madhe të popullsisë, prej 36.5, është shënuar në Kamënicë. Në Fushë-Kosovë, po ashtu, jetojnë më së shumti persona në një metër katror, përkatësisht 762. Në ngjarjen e organizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës mori pjesë edhe kryeministri Albin Kurti, i cili në adresimin e tij tha se realizimi i regjistrimit të popullsisë ka qenë një nga projektet më me prioritet të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë këtij viti, duke marrë parasysh rëndësinë e të dhënave në kohë si dhe raundin e regjistrimeve globale (2015-2024). “Ky regjistrim nuk është thjesht një ushtrim statistikor. Është një

reflektim i përkushtimit tonë për të kuptuar dhe adresuar nevojat e popullatës sonë, duke siguruar si shpërndarje të barabartë të burimeve, po ashtu edhe hedhje të bazave për vendimmarrje të informuar që do të formësojë të ardhmen e Kosovës”, u shpreh ai. Kurti ka thënë se statistikën janë një e mirë publike dhe duhen përdorur për marrjen e vendimeve bazuar në dëshmi. “Në demokraci marrja e vendimeve politike duke u bazuar në dëshmi, pra statistika, është shumë me rëndësi për të siguruar transparencë dhe logaridhënie”, shtoi më tej kryeministri. Ai i falënderoi qytetarët, partnerët dhe institucionet publike, në krye me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, për punën e palodhshme dhe kontributin për realizimin e këtij projekti shumë të ndërlikuar dhe tejet të rëndësishëm për vendin. Qeveria e Kosovës, së bashku me

Agjencinë e Statistikave të Kosovës, gjatë kësaj kohe bashkërenduan aktivitetet dhe pothuajse të gjitha kërkesat e ASK-së drejtuar qeverisë u aprovuan në kohë, gjë që mundësoi një rezultat të tillë të suksesshëm. “Unë jam krenar si kryeministër i Republikës së Kosovës për përkushtimin dhe angazhimin e treguar nga të gjithë ata që morën pjesë në këtë proces”, tha ai, duke shtuar se një agjenci e fuqishme e statistikës, e cila ofron të dhëna të besueshme dhe statistika të azhurnuara, është një aset i çmuar për vendin. Kryeministri Kurti e rikonfirmoi edhe kësaj radhe përkushtimin e tij dhe të qeverisë për komunikim të hapur, bashkëpunim të ngushtë dhe bashkërendim të përkushtuar, me qëllim që ta bëjmë Kosovën një vend lider në mbledhjen, analizën dhe shfrytëzimin e të dhënave statistikore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Duke filluar nga 5 prilli i këtij viti, për 50 ditë, rreth 2 600 regjistruar në 38 komuna të Republikës sonë mbledhën të dhëna esenciale për politikën, strategjitë, projektet e vendimet e shtetit për dekadën e ardhshme. Nga aspekti profesional e teknik, procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave u vlerësua me nota të larta nga ekipet monitoruese të organizatave ndërkombëtare partnere, UNFPA dhe UNECE.

Këto janë nëntë komunat me rritje të banorëve

Komunat ku ka pasur rritje janë: Fushë-Kosova, Parteshi, Shtërpçë, Graçanicë, Kllokot, Prishtinë, Obiliq, Mamush dhe Ferizaj. Fushë-Kosova ka rritje të popullsisë 83,99 për qind Parteshi ka rritje 81,93 për qind Graçanica 81,46 për qind Shtërpça ka rritje 56,71 për qind Kllokoti ka rritje 19,13 për qind Prishtina ka rritje 14,21 për qind Obiliqi ka rritje 5,78 për qind Mamusha ka rritje 1,96 për qind Ferizaj ka rritje 0,68 për qind.

Stano: BE-ja nuk merr pjesë në hedhjen e fajit mes Serbisë dhe Kosovës, palët t'i përmbushin obligimet

PRISHTINË, 12 KORRIK - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë se hedhja e fajit te njëri-tjetri ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në dialog është shumë kundërproduktiv dhe në vend të kësaj të dyja palët duhet të shikojnë se çfarë nuk kanë përmbushur nga ajo që janë marrë vesh dhe të punojnë për t'i realizuar obligimet. Ai ka përsëritur se pa përparim në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, as Serbia e as Kosova nuk mund të avancojnë drejt Bashkimit Evropian.

Në raundin e fundit të dialogut në nivelin më të lartë në Bruksel nuk ka pasur takim mes presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe, sipas Josep Borrell, Kosova nuk ishte e gatshme për këtë takim. Ndërsa Vuçiqi ka thënë se Kurti ka kërkuar që "Serbia ta njohë Kosovën".

Duke iu përgjigjur një pyetjeje në lidhje me deklaratën e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani për Zërin e Amerikës, se Serbia nuk po e zbaton pjesën e saj të marrëveshjes duke mos e njohur pavarësinë



e Kosovës dhe se Prishtina po kërkon garanci ndërkombëtare për t'i përmbushur detyrimet e saj, Stano thotë se "BE-ja është ndërmjetëse dhe nuk merret me njohjen e pavarësisë". Stano tha për "Zërin e Amerikës" se të dyja palët kanë obligime dhe se në mars të vitit 2023 janë marrë vesh në Ohër se si t'i zbatojnë ato, por kjo nuk po ndodh. "Ne nuk marrim pjesë në hedhjen e fajit. Kjo është shumë kontradiktore dhe kundërproduktive. Njëra palë fajëson vazhdimisht tjetrën dhe anasjelltas. Të gjithë duhet

të shohin se cila është detyra e tyre dhe ta përmbushin atë. Të dyja palët kanë shumë për të përmbushur", thotë zëdhënësi i BE-së. "Për shembull, për Kosovën është prioritet urgjent themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Është obligim i ndërmarrë nga Kosova shumë kohë më parë që nuk po e përmbush përkundër thirrjeve të BE-së, partnerëve amerikanë dhe të tjerëve. Edhe Serbia duhet të fillojë përmbushjen e detyrimeve të saj. Pala serbe ende ka deficite kur bëhet fjalë për çështjet që dalin nga

marrëveshja. Çështja është se të dyja palët, në vend se ta fajësojnë njëra-tjetrën dhe të hapin çështje të reja, duhet të përqendrohen në zbatimin e asaj që kanë rënë dakord në Ohër në mars të vitit 2023", thotë Stano.

Meqenëse dialogu ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në Bruksel ka ngecur për një kohë të gjatë, pyetja është se si të shkohet përpara nëse asnjëra palë nuk do të përmbushë atë që kërkon tjetra - njohjen e pavarësisë apo formimin e Asociacionit.

Stano përkujton se të dyja palët kanë rënë dakord që integrimi i tyre evropian të lidhet me dialogun. "Serbia dhe Kosova e kanë shpallur integrimin evropian si prioritet strategjik. Ata, gjithashtu, u obliguan për lidhjen e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me përparimin në rrugën e pranimit në BE. Nëse nuk ka përparim në dialog, nuk ka përparim në anëtarësimin në BE, është shumë e thjeshtë. Ne jemi ndërmjetës dhe i ndihmojmë ata të arrijnë një konsensus, por në fund, të dyja palët duhet të

arrijnë një marrëveshje, të arrijnë një kompromis, t'i normalizojnë marrëdhëniet, sepse vetëm kështu do të mund të ecin përpara dhe të afrohen me BE-në", përfundoi zëdhënësi i BE-së.

Në mars të vitit 2023 Serbia dhe Kosova arritën Marrëveshjen e Ohrit, e cila përcakton zbatimin e marrëveshjes bazë. Obligimet nga ato dokumente nuk janë zbatuar, si dhe obligimi i Kosovës për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i cili ishte përcaktuar me Marrëveshjen e Brukselit në vitin 2013.

Ndërkohë, tensionet në terren po përshkallëzohen dhe kulmuan me një sulm të armatosur nga serbët ndaj policisë së Kosovës në Banjskë në shtator të vitit 2023, ku u vranë katër persona [një pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe tre serbë nga grupi terrorist]. Organizatorët e atij sulmi nuk u sollën para drejtësisë, kurse përgjegjësinë për sulmin e mori biznesmeni serb Milan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, parti politike e serbëve të Kosovës, e afërt me Beogradin zyrtar.

Osmani në mesin e liderëve botërorë: Hera e parë që Kosova u përfshi në një samit të NATO-s



PRISHTINË, 12 KORRIK - Presidentja Vjosa Osmani, me ftesë të presidentit amerikan Joe Biden, përfaqësoi Kosovën në aktivitetin përmbyllës të Samitit të NATO-s në Uashington. Pjesëmarrjen në këtë aktivitet të Samitit të

NATO-s presidentja Osmani e ka vlerësuar të një rëndësie të veçantë për shtetin e Kosovës. "Është hera e parë në histori që Kosova përfshihet në një Samit të aleancës së shpresës dhe për këtë u jam mirënjohëse personalisht

presidentit Biden dhe ShBA-së", ka theksuar presidentja Osmani.

Iniciativa Ukraine Compact, si aktivitet përmbyllës i Samitit të NATO-s, është pjesë e përkushtimit të NATO-s dhe partnerëve të saj për sigurinë

afatgjatë të Ukrainës. Kjo iniciativë e NATO-s krijon një arkitekturë gjithëpërfshirëse të sigurisë për t'i forcuar kapacitetet mbrojtëse të Ukrainës.

Në përfundim të Samitit, presidentja Osmani ka

biseduar me presidentin Biden, të cilin e ka falënderuar për kontributin dhe përkushtimin ndaj Kosovës, si dhe ka pasur mundësi të diskutojë edhe me liderë të tjerë nga disa shtete të botës.

Oficerë të FSK-së diplomojnë në Shqipëri

TIRANË, 12 KORRIK - Në ambientet e amfiteatrit të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë në Republikën e Shqipërisë ka organizuar ceremoninë e diplomimit të kursantëve të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursit të Lartë të Oficerit. Programet e këtyre kurseve

ofrojnë dhënien e njohurive të nevojshme për planifikimin dhe drejtimin e operacioneve luftarake në një mjedis operacional kompleks që lidhet me sigurinë kombëtare, aftësimin për të marrë vendime të drejta dhe për të dhënë këshilla të sakta në rastet kur shqyrtohet përdorimi i forcës ushtarake. Në këtë ceremoni në Kursin e Komandës dhe Shtabit të

Përgjithshëm (KKShP) kanë diplomuar katër oficerë nga FSK-ja si dhe në Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) dy oficerë. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës, po ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale në të gjitha nivelet e edukimit ushtarak.



BSPK-ja: Temperaturat janë ekstreme, punëtorët të pambrojtur



PRISHTINË, 12 KORRIK - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka reaguar lidhur pas temperaturave të larta dhe rrezikut për punëtorët. BSPK-ja thekson se derisa temperaturat vazhdojnë të rriten, siguria dhe mirëqenia e punëtorëve të ndërtimit janë në rrezik më të madh se kurrë më parë. “Pak ose aspak po zbatohen masat gjithëpërfshirëse për ta mbrojtur nga rreziqet e nxehtësisë ekstreme fuqinë tonë punëtore të përkushtuar. Nuk mjaftojnë programet dhe fjalët për t'i përmirësuar kushtet e punës në temperatura ekstreme kur punëtori duhet të punojë në goditje të

drejtpërdrejta të rrezeve të diellit. Puna nën rrezet e diellit këto ditë vape po i godet punëtorët e ndërtimit, të ndërtesave dhe rrugëve. Protokollet për monitorimin e ekspozimit ndaj nxehtësisë, dhe udhëzimet për menaxhimin e sëmundjeve të lidhura me nxehtësinë e drejtpërdrejta, janë të pakta dhe punëtori është i pambrojtur”, thuhet në reagim. BSPK-ja thekson se punëtorëve u mungojnë pajisjet e duhura mbrojtëse dhe veshja e përshtatshme për punë në kushte ekstreme, dhe ata nuk kanë fare mbrojtje nga dielli i ashpër dhe temperaturat e larta. “Punëtorët

janë të shtyrë të punojnë në piskun e vapës dhe nuk kanë mundësi ta përshtatin orarin e punës në pjesët më të freskëta të ditës, siç janë mëngjeset e hershme dhe mbrëmjet. Ky rregullim është thelbësor për ruajtjen e shëndetit dhe produktivitetit të punëtorëve tanë. Ende nuk janë bërë detyruese për punëdhënësit kontrollet e rregullta shëndetësore të punëtorëve, po as monitorimi i temperaturës së trupit dhe shenjave vitale, dhe kjo u mbetet lajmeve kur ndodhin incidentet e lidhura me nxehtësinë dhe temperaturat e larta - po atëherë gjithçka është vonë”, thuhet në reagim.

Vlerësohet puna e stacioneve policore në Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Han të Elezit

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 KORRIK - Në mbështetje të detyrave dhe përgjegjësi që ka Drejtoria Rajonale e Policisë, nënkoloneli Faton Pllana ka thirrur në takim shefat e sektorëve rajonalë dhe komandantët e stacioneve të policisë: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Hani Elezit. Drejtori Rajonal i Policisë, nënkoloneli Faton Pllana, para të pranishmëve ka paraqitur raportin gjashtëmuor të vitit 2024 të krahasuar me raportin gjashtëmuor të vitit 2023 dhe planifikimin e realizimin e objektivave për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2024. Në këtë takim, veç të tjerash, Pllana vlerësoi dhe lavdëroi punën e mirë të secilit stacion dhe njësi rajonale gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 dhe i ka inkurajuar të pranishmit që aktivitetet e policisë rajonale të



shtohen edhe në pjesën e dytë të vitit 2024, duke i koordinuar punët.

Ai rekomandoi që të hartohen plane të nevojshme operative karshi situatave të paraqitura dhe

analizave të dala nga raporti gjashtëmuor. Pllana përmendi edhe disa

projekte dhe fushata vetëdijesuese që janë realizuar me komunitetin dhe rekomandoi që të vazhdohet me projekte dhe fushata të ndryshme në sensibilizimin e qytetarëve rreth dukurive negative në shoqëri. Në këtë takim ai i siguroi qytetarët e rajonit të Ferizajt se do të ndërmerren masa të nevojshme, duke shtuar praninë policore në të gjitha stacionet e policisë së rajonit të Ferizajt. Veç policëve me uniformë do të angazhohen edhe pjesëtarë të policisë me rroba civile dhe me automjete zyrtare civile për t'i parandaluar veprat penale të incidenteve dhe të aksidenteve në rrugë. Me këtë rast, ai i ka ftuar qytetarët për bashkëpunim, nëse kanë informacione rreth kriminalitetit në përgjithësi, por edhe të kundërvajtjeve në komunikacion, të njoftojnë menjëherë stacionin më të afërt të policisë, apo përmes aplikacionit digjital “Lajmëro policinë”.

Sveçla vlerëson punën e forcave të Karabinierit në Kosovë

PRISHTINË, 12 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të premten në takim kolonel Massimo Rosati, komandant i Karabinieri MSU në Republikën e Kosovës. Ministri Sveçla dhe kolonel Rosati diskutuan për

aktivitetet e forcave të Karabinierit, me ç'rast ministri Sveçla shprehu mirënjohjen për shërbimin që forcat e Karabinierit po e kryejnë në Republikën e Kosovës me qëllim që së bashku me institucionet të garantojnë

ambient të qetë dhe të sigurt për qytetarët. Të dyja palët u pajtuan për bashkëpunim të mëtejshëm si në aspektin profesional mes zyrtarëve, po ashtu edhe në atë operativ që garanton siguri dhe stabilitet në vend.



AAK-ja do ta dërgojë në Kushtetuese statutin e ri të UP-së: Ka shkelje procedurale

PRISHTINË, 12 KORRIK - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Shemsedin Dreshaj, ka thënë se do ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese Statutin e ri të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Në një konferencë për medie, Dreshaj ka thënë se kapja e shtetit po bëhet nga secili nivel dhe e njëjta ka ndodhur edhe me miratimin e statudit të ri të UP-së. “Ky status bie

ndesh me arsimin e lartë, kurse përveç shkeljeve që i ka dy, edhe në përmbajtje është më i keq. Mbledhja e djeshme nuk ishte shembull i mirë i lirisë së të shprehurit, për media dhe arsimin e lartë. Ky statut vazhdon ta prekë mirëmbajtjen, shkollimin, mbajtjen e thirrjeve në nivel vendi gjë që nuk ka ndodhur as në vende komuniste më herët. Ky statut së pari ka shkelje

procedurale, debati publik me palët e interesit dhe me media nuk është bërë në mënyrën e duhur, gati në mënyrë klandestine është sjellë në Kuvendin e Kosovës”, ka thënë Dreshaj, duke shtuar se grupi parlamentar i AAK-së ka vendosur të dakordohet dhe ta marrin pajtueshmërinë që këtë vendim ditëve të ardhshme ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim.



Qeveria mbron Projektligjin për KPM-në

PRISHTINË, 12 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka mbrojtur Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve (KPM), që u miratua në lexim të dytë gjatë seancës plenare të 11 korrikut. Ky ligj, veç të tjerash, parasheh licencimin e medieve online, monitorimin e tyre dhe gjoba deri në 40 mijë euro. Miratimi i këtij projektligji u kritikua nga Bashkimi Evropian, nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, dhe dy parti opozitare, që paralajmëruan se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. “Ky ligj në radhë të parë sjell barazi dhe konkurrencë të shëndoshë në treg, sepse ky ligj në plotëni përcjell direktivën për Shërbimet e Mediave Audiovizuale [AVMS] të Bashkimit Evropian, hartuar nga ekspertët e Bashkimit Evropian”, tha Qeveria e Kosovës përmes një reagimi në orët e vona të së enjtes. Për këtë projektligj disa ditë para se të miratohej në lexim të dytë, kishte reaguar Zyra e BE-së në Kosovë, duke thënë se pavarësisht se versioni aktual ka përfshirë disa rekomandime të Këshillit të Evropës, legjislacionit i duhen rishikime të mëtejme që të përmirësohet qartësia ligjore dhe të përshtatet edhe më shumë me standardet e bllokut evropian dhe Këshillit të Evropës. Qeveria tha se Projektligji për KPM-në respekton Direktivën e BE-së është i harmonizuar me legjislacionet që janë në fuqi dhe siguron “zbatimin e të drejtave të garantuarave përgjegjësi të mveshura për të gjitha subjektet, nga një organ i pavarur kushtetutës, pra KPM”.



Çfarë parasheh projektligji për KPM-në?

Projektligji i miratuar të enjten, më 11 korrik, parasheh licencimin dhe kontrollimin e medieve online që prodhojnë video prej KPM-së, më herët në këtë organ kanë qenë të obliguara që të regjistrohen vetëm mediet audiovizuale. Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) - i themeluar në vitin 2005 -

është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. Sipas këtij projektligji, mediet që funksionojnë si organizata joqeveritare do të duhen të hapin kompani që t'i plotësojnë kushtet e licencimit nga KPM-ja. Po ashtu, mediet duhet të marrin leje prej KPM-së në rast të ndryshimit të pronësisë mbi 10 për qind. Sipas tij, mediet online do t'i

nënshtrohen regjimit të sanksioneve me vlerë në deri 40 000 euro për shkeljet eventuale siç janë: mosrespektimi i ligjit, mosdorëzimi i raportit vjetor te KPM-ja brenda afatit, mosruajtja e arkivit të transmetimeve, mosrespektimi i kohës së përcaktuar për transmetim, si dhe për disa raste të tjera. Përveç përfshirjes së medieve online që prodhojnë video nën monitorimin e KPM-së, projektligji i ri parasheh edhe

rritjen e numrit të anëtarëve të KPM-së nga shtatë në 11 dhe zgjatjen e mandatit të tyre. Anëtarët e KPM-së votohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe, sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), kjo rritje e stafit në KPM mund të keqpërdoret nga qeveria “për t'i dërguar njerëzit e tyre”, të cilët do të mund të qëndronin më gjatë në pozitat e tyre, duke rrezikuar kështu, sipas tyre, pavarësinë e KPM-së. Projektligji për KPM-në është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 27 dhjetor të vitit të kaluar, dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës, ku është miratuar në lexim të parë më 7 mars të këtij viti. Pas miratimit në lexim të dytë, duhet të nënshkruhet nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) i patën bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë menjëherë prej ndryshimeve në projektligj, pasi diçka e tillë ishte konsideruar “sulm mbi mediet”. Misioni i OSBE-së dhe i BE-së më herët kanë thënë se mbështesin qëllimin e projektligjit për ta harmonizuar legjislacionin e Kosovës me dispozitat përkatëse të BE-së, duke përfshirë Direktivën e shërbimeve audio-vizuale por, “siç thekson raporti i Këshillit të Evropës, nevojitet më shumë punë në draft për të siguruar që ai mos ta nënvlerësojë pavarësinë e KPM-së dhe as të mos krijojë mospërputhje ligjore”.

Telekomi filloi zëvendësimin e BTS-ve me teknologjinë e fundit 5G

PRISHTINË, 12 KORRIK - Ministria e Ekonomisë (ME), Artane Rizvanolli, ka njoftuar se së bashku me kryeshefen ekzekutive të Telekomit të Kosovës, Burbuqe Hana, kanë parë nga afër zëvendësimin e një nga BTS-të në qendër të qytetit të Prishtinës, pikërisht mbi ndërtesën ku është e vendosur Ministria e Ekonomisë. Ministria Rizvanolli ka

theksuar se zëvendësimi i teknologjisë është pjesë e modernizimit të rrjetit mobil në të gjithë Kosovën dhe brenda pak ditësh në Prishtinë do të përfundojë zëvendësimi i të gjitha pajisjeve me pajisje të reja të teknologjisë së fundit 5G, ndërsa deri në fund të vitit do të përfundojë modernizimi i rrjetit në tërë Kosovën. “Kryeshefja më rekomandoi

të blija një pako më të madhe nga Vala për shkak të mundësive të reja që ofron teknologjia 5G. Së bashku vizituam pikën e Valës në Sheshin ‘Zahir Pajaziti’, e cila tash paguan qira shumë më të ulët se para tri vitesh. Aty u prita ngrohtësisht nga punëtorët në një ambient pune modern e të këndshëm”, ka pohuar Rizvanolli.



Trajnimet për sigurinë në punë, për disa të padëgjjuara



PRISHTINË, 12 KORRIK - Një punëtor ndërtimi 55-vjeçar në Prishtinë ka frikë të vazhdueshme për sigurinë e tij në punë për shkak të lartësisë së skelave dhe mungesës së trajnimeve për sigurinë. Pavarësisht prej 24 vjetëve përvojë në këtë sektor, ai thotë se asnjë kompani nuk i ka ofruar trajnime të tilla. Ato kërkohen ligjërisht, por pajtueshmëria është e ulët - kompanitë shpesh veprojnë vetëm në presionin e inspektimeve të punës. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës shpreh shqetësim për shkallën e lartë të lëndimeve dhe vdekjeve në ndërtimtari. Këtë muaj një punëtor ka vdekur në vendin e tij të punës. Gjatë gjithë vitit të kaluar - 11.

“Duhet të kujdesemi vetë”

“Jo, jo, asnjëherë nuk më ka mësuar askush për rreziqet”, thotë punëtori 55-vjeçar, i cili nuk do që të identifikohet. “Nëse do, kërce prej skelës; nëse do, qëndro! Askush nuk të mëson asgjë, vetëm duhet të kesh kujdes vetë”, thotë ai. Për plot 24 vjet ai punon në sektorin e ndërtimtarisë, kryesisht në Prishtinë, dhe jo rrallë thotë se është lënduar në punë për shkak të kushteve jo të sigurta. Duke folur për “Radion Evropa e Lirë” tregon se ka punuar për disa kompani ndërtimore, por që në asnjërin nuk është diskutuar për ndonjë trajnim për sigurinë dhe shëndetin në punë. Në Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë thuhet se siguria, trajnimi i punëtorëve, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive janë obligime që duhet t'i zbatojë secili punëdhënës për të punësuarit e tij. “Në çdo sekondë të punës ndihem

i rrezikuar. Një skele nëse nuk është e lidhur mirë, unë mund të bie nga lartësia”, thotë 55-vjeçari. Jo larg kompanisë ku punon ai, në një lagje të Prishtinës, punon edhe Flamur Osmani, 58 vjeç. Edhe ai është mbi 20 vjet në sektorin e ndërtimtarisë, por ka një përvojë ndryshe. Thotë se në biznesin ku aktualisht punon, ka trajnime për siguri në punë, qoftë nga punonjësit e kompanisë, qoftë nga kompani të licencuara për këtë çështje. “...por, kjo nuk e eliminon rrezikun. Duhet të kujdesimi vetë, e dimë se është punë me rrezik. Ne i kemi pajisjet mbrojtëse, por përveç helmetës që e bartim, të tjerat nganjëherë jo...”, thotë Osmani për “Radion Evropë e Lirë”. Udhëheqës të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) shprehen të shqetësuar me, siç thonë, kushtet e rënda me të cilat përballen punëtorët e ndërtimtarisë në punë. Kreu i BSPK-së, Atdhe Hykolli, thotë se mostrajnimi i punëtorëve ka bërë që në këtë sektor të ketë numër të lartë të atyre që lëndohen ose vdesin në punë. Më 4 korrik, në qytetin e Lipjanit, një punëtor ka vdekur teksa punonte në një kompani ndërtimore. Ky është rasti i parë i tillë këtë vit, thonë nga Inspektorati i Punës. Vitin e kaluar kanë qenë 11 persona që kanë humbur jetën në vendet e punës, kurse në vitin 2022 janë evidentuar 15 vdekje si pasojë e kushteve të punës. Bazuar në shifrat e Inspektoratit të Punës, nga viti 2013 deri më 2023, në Kosovë kanë humbur jetën 147 punëtorë në vendet e tyre të punës, kurse janë lënduar 933. Shumica e këtyre rasteve janë regjistruar në sektorin privat.

Pak kompani kryejnë trajnime për sigurinë e punëtorëve

Procesi i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë kryhet nga kompani të licencuara. Ai realizohet në ambientet e punës dhe më pas përgatitet dokumenti i vlerësimit të rrezikut, ku përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, identifikohen burimet e rrezikut, përcaktohet se kush mund të rrezikohet, nga çfarë dhe si, e po ashtu edhe masat e nevojshme. Në Kosovë janë të licencuara 20 kompani të tilla, bëjnë të ditur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për “Radion Evropë e Lirë”. Sektori privat në Kosovë llogaritet si punëdhënësi më i madh - me rreth 99 mijë biznese aktive dhe me mbi 220 mijë të punësuar. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, në nivel vendi operojnë 720 kompani ndërtimore. Nga Shoqata e Ndërtimtarëve të Kosovës nuk iu përgjigjen direkt pyetjes së “REL”-it se a mbajnë trajnime për punëtorët, por thanë se “ky proces është obligim ligjor” dhe se “kjo çështje duhet të monitorohet nga Inspektorati i Punës”. “REL”-i kontaktoi disa kompani ndërtimore, private e publike, në lidhje me këtë temë, por nuk mori përgjigje prej asnjërës. Nga Inspektorati i Punës bëjnë të ditur se “nga muaji janar deri në muajin qershor të këtij viti, 213 subjekte e kanë përfunduar procesin e vlerësimit të riskut në punë dhe janë trajnuar 1.174 të punësuar”, por nuk sqarojnë se a bëhet fjalë për subjekte private apo

publike dhe cilëve sektorë u përkasin. Disa kompani që ofrojnë trajnime për sigurinë, thonë se bizneset private nuk janë vetëdijesuar ende sa duhet për rëndësinë e këtyre shërbimeve. Sipas përfaqësuesve të tyre, trajnimet, në shumicën e rasteve, realizohen pasi ato kushtëzohen nga Inspektorati i Punës, i cili bën kontrolle në terren. Minir Curri, udhëheqës i kompanisë B&M SHPK, thotë se bizneset private janë të njoftuara për këtë obligim ligjor, por se shumë prej tyre nuk e kryejnë. “Në rastet kur ky proces kërkohet nga Inspektorati i Punës, nuk diskutohet, ai përfundon 100%. Kurse, me vetiniciativë, përqindja është e vogël. Ende mungon kultura dhe vetëdija e punëdhënësit se kjo është në të mirë të tyre. Në bazë të përvojës në treg, mund të them se 15 për qind e kompanive i bëjnë [trajnimet]”, thotë Curri. Ngjashëm pohojnë edhe në kompaninë European College of Kosovo - “numri më i madh i ndërmarrjeve e kryen vlerësimin e riskut vetëm pas kërkesës së Inspektoratit të Punës”, sipas tyre. Ruzhdi Feka, drejtor i kompanisë së trajnimeve Blitermeng-Protect Consulting Group, thotë se kompanitë që bëjnë kërkesa me vetiniciativë për t'i trajnuar punëtorët e tyre në fushën e sigurisë, “janë të vetëdijshme për rëndësinë e sigurisë dhe dëshirojnë t'i minimizojnë rreziqet dhe aksidentet në vendin e punës”.

Çelësi tek inspektimet

Atdhe Hykolli, nga BSPK-ja, konsideron se për të rritur nivelin e sigurisë dhe për të mbrojtur

shëndetin e punëtorëve, Inspektorati i Punës duhet t'i kontrollojë këto biznese dhe t'i ndëshkojë ato që nuk e kryejnë obligimin e trajnimeve. “Nëse Inspektorati i Punës nuk i trajton në mënyrë rigorozë këto raste dhe nuk merret më seriozisht me gjendjen e punëtorëve në sektorin e ndërtimtarisë, duke i shtuar kontrollet, duke kërkuar dokumentet e vlerësimit të riskut, unë kam frikë se do të përsëriten rastet e lëndimeve dhe të vdekjeve në vendet e punës”, thotë Hykolli. Nga Inspektorati i Punës nuk japin përgjigje specifike për sektorin e ndërtimtarisë, por thonë se “përgjatë viteve 2022 dhe 2023, numri i inspektorëve të punës është dyfishuar, duke u ngritur në mbi 60 në përgjithësi” dhe se këtë vit planifikohen, gjithashtu, rekrutime shtesë. Në deklaratën dhënë “REL”-it thuhet se nga muaji janar deri në muajin qershor të këtij viti janë realizuar rreth 6.000 inspektime dhe janë shqiptuar 787 masa ndëshkimore, por për këto të fundit nuk jepen hollësi. Me Ligjin e Punës dhe me Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë, dënimet për punëdhënësit, për shkak të mungesës së sigurisë në ambientet e punës, janë nga 100 deri në 35.000 euro. Por, mungesa e trajnimeve për sigurinë nuk është e vetmja gjë për të cilën ankohen punëtorët. Në raportet e Avokatit të Popullit konstatohet shpesh se në sektorin publik, e sidomos në atë privat, ka shkelje të ndryshme të të drejtave të punëtorëve, si: ndërprerje e marrëdhënies së punës në mënyrë joligjore, kohëzgjatje e orarit të punës, moskompensim për punë jashtë orarit, mohim i së drejtës për pushim vjetor e të tjera.

Trimi shqiptar të cilit analfabetizmi i kushtoi me jetë

Nga: Agron ISLAMI

Halil Patrona, një shqiptar nga Hurpishteja i cili ia dha fund Periudhës së Tulipanit (1703-1730), duke shkarkuar sultanin [Ahmed III] dhe marrë edhe kokën Ibrahim Pashës (sadriazamit). Në realitetin e ri, Halili në një mënyrë e kishte kapur shtetin dhe si i tillë mbante dhe fjalime të zjarra para masave të mëdha në Stamboll. Një ditë, derisa po mbante një fjalim, truproja e tij i dorëzoi një copë letër ku shkruhej: “Mos shko në saraj, të kanë ngritur kurth dhe të likuidohesh.” Bëhej fjalë për ftesën e Sulltan

Mahmudit të Parë dhe “darkën” që ai e kishte përgatitur për Halilin dhe shokët e tij në Saraj. Megjithëse informata për planin e Sulltanit për të vrarë Halilin me shokë gjendej në xhepin e këtij të parit, ata prapë shkuan në darkën e vdekjes. Në fakt, Halili nuk e dinte çfarë shkruante në atë letër, sepse ai nuk dinte shkrim dhe lexim, por që mosdijen e kishte fshehur nga shokët e tij dhe nga masa. Madje, letrës ia kishte hedhur një sy, për t’u dukur njeri i lexueshëm, e më pas e kishte futur në xhep. Kështu, ai e “ruajti” karizmën edhe për disa orë. Përfundimi i fshehjes së mosdijes ishte likuidimi...



Marloui, poet po aq i madh sa Shekspiri: Pse e neglizhojmë?

Nga: Ben LAWRENCE / *The Daily Telegraph*

Është e pamundur zbutja e Kristofer Marlouit [Christopher Marlowe]. Jeta e tij e zymtë, e cila ndoshta përfshinte kohën si spiun qeveritar dhe fundin me vdekje të dhunshme në një tavernë në jug të Londrës, ka lënë në hije punën e tij si poet dhe dramaturg. Si rrjedhojë, realizimet e dramave të tij – shumica e të cilave interpretohen shumë rrallë – ndihen si përafrime të biografisë së këtij djali të keq elizabetian: gjakderdhje që i afrohet absurditetit. Natyrisht, kjo është tmerrësisht e padrejtë, meqë përul intelektin e tij të rrëmbyeshëm. Prandaj, shpresoj që shpallja e Teatrit të Marlouit për një grup të plotë veprave të filmuara (që do të dalin në treg në muajin e ardhshëm), do të ndihmojë disi në rivendosjen e reputacionit të Marlouit, duke e lejuar atë të dalë nga hijja e bashkëkohësit të tij Uilliam Shekspir [William Shakespeare]. Ka arsye të dukshme se pse Shekspiri dominon jetën tonë kulturore dhe Marlouin jo. Marloui nuk e ka mprehtësinë psikologjike të Bardit: personazhet e tij janë të bekuara me pak dyshime për veten dhe pa momente epifanike, ndërsa trajektorja e tyre zakonisht lidhet me fetishin për pushtet, qoftë nëpërmjet parave, pushtimit apo njohurive. Shfaqjet e tij ndihen të drejtpërdrejta dhe shpeshherë të pamëshirshme – manifestime të botës së dhunshme në të cilën ai jetoj. E, megjithatë, është e vështirë ta përshkruash Marlouin si krijues të ngushtë. Shfaqja si Tamerlani i Madh, për jetën e perandorit të Azisë Qendrore të shekullit të XIV,





përmban ide të mëdha. Zhvillohet në një skenë botërore, por megjithatë bën arsyetime për individualizmin, ndërkohë që është ende i vetëdijshëm për kufizimet e veta. Për ata – dhe unë dyshoj se ka shumë – të cilët mendojnë se Marloui është i mërzitshëm sepse ai nuk është i rëndësishëm, ata duhet të shikojnë Tamerlanin i cili është ende aktual për këtë kohë të despotëve dhe që ka një skenë në të cilën ai e djeg Kuranin, gjë që mbetet një nga më momentet më provokuese në historinë e teatrit. Çuditërisht, regjisorët e fundit e kanë hequr këtë skenë, veçanërisht në një realizim të vitit 2005 në Barbikan, për çfarë regjisorit David Farr u akuzua për censurë. Doctor Fausti, shfaqja më e shpeshtë e Marlouit, është gjithashtu më e keqkuptuara e tij. Kritikët pretendojnë se është

zhytur në një koncept mesjetar të Parajsës dhe Ferrit të cilin audienca moderne e sheh si diçka të tejkaluar. Kjo më duket irrituese: ajo që Fausti ilustrohet në mënyrë kaq të mirë është se Marloui është kapur mes Mesjetës dhe epokës së hershme moderne, mes besimit të demonët dhe mendimit racional e shkencor. Kjo nuk është befasi: i kishte kaluar ditët e tij në Kembrixh duke u zhytur te Ovidi kur duhej të studionte teologjinë. Trazira te Marloui ekziston në mendimet e tij fetare (nuk ishte tamam jobesimtar, por sigurisht që ishte racionalist); në botëkuptimin e tij intelektual dhe në seksualitetin e tij. Si homoseksual dhe heterodoks, puna e tij gjithmonë do të ishte e ndërlikuar. Dhe, kjo mund të jetë problem për krijuesit e teatrit të

cilët mund të ankohen se Marloui tenton të intelektualizojë gjithçka – ndryshe nga ai bir i vetvetishëm i tokës dhe kohës së vet. Megjithatë, puna e Marlouit, nëse bëhet siç duhet, mund të lëndojë emocionalisht. Kjo shihet më qartë te Eduardi II, ku shqyrton marrëdhënien me mbarim të keq mes monarkut të Plantagenëve dhe të dashurit të tij Piers Gaveston. Ta quash Eduardin II “shfaqje homoseksuale”, kjo është anakronike, por megjithatë ndihet si lutje për të drejtat e homoseksualëve, sepse është kaq e hapur ndaj mbretit dhe të preferuarit të tij. Ndoshta edhe sot kjo paraqet problem për Marlouin – kjo dashuri ku në qendër ka mashkullin, nuk mund të ketë aq rëndësi për audiencën, ose në disa raste të

tolerohet po aq sa dashuria konvencionale që shohim te Shekspiri. Marloui vdiq në moshën 29-vjeçare – nuk do të kënaq teoricienët e konspiracionit të cilët besojnë se ai mbijetoi dhe se vazhdoi të shkruajë veprat e plota të Shekspirit – dhe rrjedhimisht dramat e tij janë drama të të rinjve, me gjithë zellin dhe bollëkun që kjo nënkupton. Është i trishtueshëm fakti se nuk i kemi parë kurrë veprat e pjekura të Kristofer Marlout. Megjithatë, besoj se në poezinë e tij e kemi një aluzion të asaj që do të vinte. Në fakt, këtu mendoj se e shihni më qartë shkëlqimin e Marlouit dhe aty do të drejtoja unë këdo, skeptikët apo ata që s’e njohin punën e tij. Ai është përgjegjës për poemën baritore Bariu i pasionuar pas dashurisë së vet, që na jep vargun e përsosur: “Eja të jetosh me mua dhe bëhu dashuria ime”; ndërkohë, poema e papërfunduar narrative e dashurisë, Heroi dhe njeriu luan, është po aq e mirë sa çdo gjë që shkroi Shekspiri dhe sigurisht më e preferueshme se Venera dhe Adonis, një tjetër romancë nga Ovidi. Puna e Marlouit është në të njëjtën kohë prekëse dhe qesharake, e çuditshme dhe e pashpjegueshme – “Trupi i tij ishte i drejtë si shkopi i Kirkës; Jupiteri mund nxirrte nektar nga dora e tij” – mungesa e përfundimit është të njëjtën kohë zhgënjim dhe dhimbje. George Bernard Shaw e mallkoi Marlouin kur e përshkroi atë si “bisha e vërtetë elizabetiane me vargjet bosh”. Shaw e kishte gabim në lidhje me këtë, pasi ai kishte gabuar për shumë gjëra. Marloui ishte vizionar, i zgjuar dhe, nëse e shikoni si duhet, ishte human. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Largohet trajneri Brando, vjen sulmuesi Fiton Hajdari

Liria e Prizrenit ka mbetur pa trajner, pasi Erdogan Brando është larguar për arsye personale. Klubi i Ligës së Parë ka njoftuar se po punon për gjetjen e trajnerit të ri, kurse të premten në këtë klub ka “aterruar” një përforcim i madh - Fiton Hajdari

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Skuadra e Lirisë ka njoftuar se Erdogan Brando ka dhënë dorëheqje nga pozita e trajnerit. Lajmin e ka dhënë klubi prizrenas në “Facebook”. Kjo skuadër ka njoftuar se Brando do të jetë në të ardhmen e afërt pjesë e klubit, përkatësisht në akademinë e klubit. “FC Liria njofton me keqardhje se trajneri ynë, Erdogan Brando, po jep dorëheqje nga pozita për arsye personale. Ne e kuptojmë dhe e respektojmë vendimin e tij, duke u dhënë përparësi nevojave të tij personale në këtë kohë. Trajneri Brando ka qenë një pjesë e çmueshme e ekipit tonë, duke demonstruar përkushtim të jashtëzakonshëm, ekspertizë dhe udhëheqje. Ne jemi thellësisht mirënjohës për kontributin e tij dhe ndikimin pozitiv që ka pasur te lojtarët dhe

klubi ynë. Kërkimi për një trajner të ri do të fillojë pa humbur kohë dhe ne do ta njoftojmë trajnerin e ri sapo të kemi diçka zyrtare. Jemi të përkushtuar për ta gjetur kandidatën e duhur që do të vazhdojë ta drejtojë klubin tonë përpara. Ne gjithashtu dëshirojmë të informojmë se, sapo ai të jetë gati, në një të ardhme të afërt, Brando do të marrë një rol të rëndësishëm në akademinë tonë, e cila do të jetë e ardhmja e këtij klubi dhe qyteti. Kontributi dhe përvoja e tij do të jenë thelbësore për zhvillimin e talenteve të rinj. Faleminderit trajner Brando për gjithçka që keni bërë për FC Lira! Ju urojmë të gjitha të mirat në të ardhmen”, thuhet në njoftimin e Lirisë.

Skuadra e Lirisë është krenuar në prezantimin e sulmuesit Fiton Hajdari, i cili ka lindur në Prizren. Liria i ka numëruar sukseset e Hajdarit një nga një, derisa ndihet

me fat që e sjell gjithë atë përvojë në klub. “Sulmit të FC Liria po i shtohet përvoja dhe historia e futbollit tonë. Kemi nderin ta zyrtarizojmë Fiton Hajdarin si prurjen më të re në ekip. Hajdari, i cili luan kryesisht në krahët e sulmit, sjell me vete një karrierë të gjatë dhe të suksesshme, duke spikatur momentet si kampion me KF Hysi në sezonin 2010/11, kampion me Trepçën 89 në sezonin 2016/17, si dhe goli i parë në histori të kualifikimeve për Evropë për ndonjë ekip nga Kosova, goli i barazimit në ndeshjen kundër ekipit nga Ishujt Faroe, Vikingur, në kohën kur vishte fanellën e Trepçës ’89”, ka njoftuar skuadra prizrenase. Hajdari, përveç Hysit dhe Trepçës ’89, Hajdari ka djersitur edhe fanellën e Llapit, Trepçës, Malishevës, Gjilanit si dhe, së fundmi, të Ferronikelit 74. Skuadra nga Prizrenit sezonin e ri futbollistik do të bëjë gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll.

SHKURT

‘Dardanët’ U20 luftuan deri në fund, por u mposhtën nga Hungaria

Kosova U20 pësoi humbje ndaj Hungarisë me rezultat të ngushtë 61:81 (20:16, 19:16, 15:25, 7:24). Djemtë e Kosovës filluan shumë mirë ndeshjen duke qenë në epërsi në dy çerekët e parë, por fati nuk ishte në anën e tyre në dy pjesët e fundit, ku kundërshtari arriti ta shkrijë epërsinë dhe të triumfojë në këtë ndeshje. Tek Kosova u dalluan Jon Ismajli me 19 pikë, 7 kërcime dhe 4 asistime, si dhe Jon Ukaj me 18 pikë, 3 kërcime dhe 1 asistim. Kosova të shtunën e zhvillon ndeshjen e dytë në FIBA U-20, Kampionati Divizioni B, nga ora 19:30 ndaj Suedisë.

Fitorja e tretë radhazi për Kosovën U16

Përfaqësuesja e Kosovës U16 meshkujt ka triumfuar edhe ndaj San Marinos me rezultat të përgjithshëm 51:105 (8:25, 12:20, 23:24, 8:36). Kjo ishte fitorja e tretë radhazi kështu duke e mbyllur grupin si lider me tri fitore në tri ndeshje. “Dardanët” edhe në këtë lojë treguan përkushtim maksimal gjë që u shpërblyen edhe me fitore. Që nga fillimi e deri në fund djemtë tanë kishin në kontroll ndeshjen, duke krijuar epërsi të konsiderueshme që nga periudha e parë. Më të dalluarit te Kosova ishin Yll Kastrati dhe Lis Binishi. Kosova U16 sot (e shtunë) luan ndeshjen gjysmëfinale me Përfaqësuesen e renditur si e dyta në Grupin A.

Broja në ‘radarin’ e Juventusit

Juventusit ka qenë shumë aktive në merkaton e kësaj vere duke bërë disa afrime të rëndësishme. Rekordmenët e Italisë tashmë janë në kërkim të një sulmuesi të fortë fizikisht, ku së fundmi qarkullon dhe emri i Armando Brojës. Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë është në pronësi të Chelseat dhe është në kërkim të një ekipi ku mund të ketë më shumë hapësira. Zgjidhja për këtë lëvizje është largimi i Milik, i cili nuk është në planet e trajnerit Thiago Motta për sezonin e ardhshëm. Broja, shihet si zëvendësuesi ideal i Vlahoviçit, ndërkohë që vlera e tij sipas Blueve të Londrës shkon në 25 milionë euro. Gjithsesi bardhezinjtë e kërkojnë në formë huazimi. “Tuttosport” shkruan se kalimi i bomberit shqiptar te Juventus mund të ndodhë sapo Milik të kalojë në Turqi, ku është dhe opsioni më konkret.

Cagliari interesohet për Dakun

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Mirlind Daku, është bashkuar me shokët e rusët e Rubin Kazanit. Zërat në merkato nuk mungojnë, ku sipas raportimeve më të fundit, të televizionit “Match TV”, për futbollistin e Kombëtares shqiptare ofertë konkrete ka dërguar klubi i Serisë A, Cagliari. Skuadra nga ishulli i Sardenjës dëshiron ta ketë në radhët e veta 26-vjeçarin, por ende nuk ka marrë një përgjigje konkrete. Më herët, vlerësimi për kartonin e Dakut në Rusi ka qenë nga 10 deri në 12 milionë euro dhe shpresa ishte që ai të kishte një rol në Evropian, mirëpo “bomberi” nga Gjilani luajti pak në Gjermani. Megjithatë, ajo që ai ka bërë edicionin e kaluar është për t’u vlerësuar, me sulmuesin shqiptar që shënoi 10 gola dhe shërbeu katër herë në 33 ndeshje.

Sot fillon Evropiani U20, na pret spektakël hendbolli

PRISHTINË, 12 KORRIK - Plot 12 ekipe kombëtare prej sot (e shtunë) deri më 21 korrik do të garojnë në Kampionatin Evropian për hendbollistët deri në 20 vjet që mbahet në Prishtinë. Ekipet kombëtare janë të ndara në katër grupe me nga tri ekipe. Pas

ndeshjeve në grupe, dy të parët e secilit grup avancojnë në çerekfinale. Çerekfinalet janë më 17 korrik, të mërkurën ndërsa gjysmëfinalet më 19 korrik. Më 21 korrik është finalja. Të gjitha ndeshjet zhvillohen në Pallatin e Rinisë dhe Sportit

në Prishtinë. Orari do të jetë i ngarkuar, ndërsa hendbolli i shfaqur pritet të jetë i nivelit të lartë. Kështu që spektakli i hendbollit është i garantuar. Përfaqësuesja e Kosovës ka pasur fazë të suksesshme përgatitore dhe me optimizëm e pret ndeshjen e

parë. Ndeshjet e së shtunës janë: Turqia - Belgjika (12:15), Gjeorgjia - Estonia (14:30), Sllovakia - Britania e Madhe (16:45), Kosova - Bullgaria (19:15). Para ndeshjes në mes të Kosovës dhe Bullgarisë është ceremonia hapëse e Evropianit.



Gazetari i 'AS': Yamal do të jetë fituesi i çmimit 'Golden Boy'

BERLIN, 12 QERSHOR - Lamine Yamal po shkëlqen në "Euro 2024". Talenti i Barcelonës po fiton admirimin e të gjithë botës, veçanërisht pas golit të mrekullueshëm kundër Francës, që i dha mundësinë Spanjës të kualifikohej për në finale. Futbollisti i momentit

është në gojë e të gjithëve kohët e fundit. Ai vazhdon të marrë lavdërime dhe duket e sigurt se shpërthimi i tij si një yll futbollit sapo ka filluar. Gazetari i "AS", Joaquin Maroto, është gjithashtu një nga anëtarët e jurisë së çmimit "Golden Boy". Në programin "Onze" të

Esport3, Maroto zbuloi se Lamine Yamal do të jetë fituesi i trofeut të këtij viti. Edhe pse votimet janë të hapura deri më 26 korrik, Maroto tashmë ka zbuluar se Yamal do të jetë fituesi. Në këtë mënyrë, futbollisti i Barcelonës, që nesër mbush 17 vjeç, do ta pasojë

Bellinghamin në këtë çmim, të cilin më parë e kanë fituar edhe futbollistë të tjerë të Barcelonës, si Messi, Cesc Fabregas, Pedri dhe Gavi. Lamine tashmë bëri histori në këtë trofe duke u dalluar si lojtari më i ri që është bërë pjesë e podiumit të "Golden Boy".



Kosova përfaqësohet në Paris edhe në Lojërat Paralimpike

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Komiteti Paraolimpik i Kosovës përmes personave me aftësi të kufizuar do të jetë pjesëmarrëse për herë të parë në Lojërat Paralimpike Botërore që do të mbahen në Paris. Më këtë rast Komiteti Paralimpik i Kosovës organizoi ngjarjen "Kosova në Paris 2024 - Histori e Re Paralimpike", e cila i dedikohet suksesit të Kosovës si debutuese në Lojërat Paralimpike Botërore që do të mbahen në Paris. Gjatë këtij takimi, të pranishmëve iu drejtua presidentja e KPK-së, Njomza Emini, zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës, Emilija Rexhepi, si dhe partnerë të KPK-së. "Jemi para një momenti historik dhe për herë të parë në historinë e sportit, Kosova përfaqësohet në lojërat paralimpike në 2024. Që nga ky moment ne duhet të jemi gati në paraqitjen e sportistëve



tanë", ka thënë Emini. Kurse zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës, Emilija Rexhepi, duke ofruar mbështetjen e qeverisë, ka thënë se ky është një moment historik për kombin. "Sot është një ditë e veçantë dhe jemi këtu për ta ofruar mbështetjen e qeverisë. Roli i qeverisë është dhënia e mundësive për sportistët. Jemi të përkushtuar të mbështesim këtë. Pjesëmarrja jonë është një moment krenarie për kombi tonë, është shembull i dëshmisë dhe

përkushtimit të sportistëve tanë", ka thënë Rexhepi. Ndërkaq të pranishëm ishin edhe parasportistët dhe pjesëtarët e delegacionit që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Paralimpike Botërore, si dhe ambasadori i Francës dhe vendeve të tjera mike. "Viti 2024 është me rëndësi jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë sportistët. Mundësi e mirë që do ta ndajmë me Kosovën, Franca qëndron pranë Kosovës dhe të gjitha komuniteteve, shpresoj se delegacioni i Kosovës t'i marrë kujtimet më të mira nga Franca", ambasadori i Francës, Olivier Guerot. "Sporti nuk ka kufi dhe nuk duhet të ketë kufi. Këto vlera përfaqësohen edhe nga Kosova. Jam i sigurt se ekipi i Kosovës do të jenë model për të ardhmen tek atletët e botës", ka shtuar ambasadori tjetër i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç.

Spanja dominon në historinë e evropianëve, Anglia kërkon trofeun e parë

BERLIN, 12 KORRIK - Spanjë - Angli do të jetë finalja e madhe e "Euro 2024". Evropiani i Gjermanisë do ta mbyllë siparin ditën e diel, më 14 korrik, në sfidën që do të luhet në Olympiastadion të Berlinit. 30 ditë të një aventure të jashtëzakonshme, ku në Gjermani nuk është folur për asgjë tjetër veçse futbollit. Nga 24 skuadrat pjesëmarrëse, tashmë do të jenë vetëm 2, finalistët e këtij evropiani që do të garojnë për 90 minuta në një "betejë" të zjarrtë për kurorën e kampionit. Spanja apo Anglia, cila do të triumfojë në kryeqytetin gjerman të dielën në mbrëmje? Por si vijnë Spanja dhe Anglia deri këtu. Faqja zyrtare e UEFA "Euro 2024" ka analizuar në detaje rrugëtimin e të dyja finalistëve dhe se si kanë mbërritur deri këtu. Fillimisht Spanja. Skuadra e teknikut Luis de la Fuente është padyshim skuadra që ka prodhuar futbollin më bindës deri më tani. 6



ndeshje, 6 fitore vetëm ajo ndaj Gjermanisë në çerekfinale e bëjnë skuadrën e "La Roja-s" favoriten e madhe të kësaj finale. 13 gola të realizuar dhe vetëm 3 të pësuar, shifra për një ekip kampion, apo jo? Për Spanjën kjo do të jetë finalja e 5-të në histori, me "furinë e kuqe" që ka fituar 3 herë (1964, 2008, 2012) dhe ka humbur vetëm 1 finale (1984). Ndërkohë Anglia është skuadra që vjen në këtë finale në mënyrë disi të çuditshme. "Tre Luanët" ishin favoritët absolutë, që përpara se të niste kampionati, e deri në

fazën çerekfinale. Por çfarë ndodhi me Anglinë? Skuadër me lojë jobindëse, shumë fat në sfidat me eliminim direkt, gola të realizuar "in-extremis", janë vetëm disa prej elementëve që vërtetojnë pakënaqësitë e tifozëve dhe medieve britanike ndaj skuadrës së tyre. 7 gola të realizuar dhe 4 të pësuar. Sa i takon historisë, Anglia ndryshe nga Spanja nuk ka një historik të pasur në këtë kompeticion. Vetëm një finale e arritur është suksesi më i madh që "Tre Luanët" kanë arritur deri më tani, ajo e Euro 2020, kur u mundën me penallti nga Italia. Mos ndoshta ka ardhur momenti, që shprehja e famshme e anglezëve, futbollit do të kthehet në shtëpi, të bëhet realitet? Për këtë duhet të presim takimin e së dielës, që do t'u japë përgjigje shumë pikëpyetjeve lidhur me enigmat e kësaj finaleje të shumëpritur.

SHKURT

Formula 1 publikon kalendarin e gjashtë garave 'sprint' për vitin 2025

Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit (FIA) ka publikuar kalendarin e gjashtë garave "sprint" që do të zhvillohen në botërorin 2025 të Formula 1. Për të pestin vit radhazi, formati i shkurtër do të jetë protagonist në këtë sport. Pistat e përzgjedhura janë ato të Shanghai (2 mars), Majemi (3 maj), SPA (26 korrik), Austin (18 tetor), Sao Paolo (8 nëntor) dhe Katar (29 nëntor). Për disa nga këto pista kjo nuk është hera e parë ku zhvillohen gara të tilla të shkurtra. Sipas FIA-s, gara sprint ka dëshmuar vazhdimisht popullaritetin e saj që nga prezantimi i saj në 2021. Formatu jep numra të fortë në të gjitha platformat e transmetimit tradicional, digjital dhe social, si dhe ofron emocione në pistë. Deri më tani, në vitin 2024, shifrat e shikueshmërisë për kualifikueset dhe garat sprint të ditës së shtunë janë rritur 40 %. Kjo bën që ky format të jetë ende pjesë e kalendarit në të ardhmen, teksa jep pikë për 8 pilotët e parë.

Finale surprizë në Wimbledon

Tenistja italiane Jasmine Paolini dhe ajo çeke Barbora Krejčíková janë dy finalistet e grand slam-it të Wimbledon për femra. Ky është turneu më i rëndësishëm i fushave me bar që po zhvillohet në Londër. Për Paolinin kjo është finalja e dytë radhazi pasa asaj të Roland Garros, por hera e parë në Wimbledon. Në gjysmëfinale, numri 7 në botë, mendi 2-1 (2-6, 6-4, 7-6) kroaten Donna Vekić, një fitore me përmbyse për Paolini. Në gjysmëfinalen tjetër, çekja Barbora Krejčíková mposhti 2-1 kazaken Elena Rybakina (3-6, 6-3, 6-4). Edhe kjo një fitore me përmbyse për çekën, numri 31 në botë, që ka fituar Roland Garros në vitin 2021. Por, ashtu si Paolini edhe për Krejčíková kjo është hera e parë që luan në finalen e Wimbledonit. Ndaj sot (e shtunë) kemi një finale historike.

Foden para finales ndaj Spanjës: Ndeshja më e rëndësishme e karrierës

Spanjë - Angli është një finale speciale, një ndeshje që premtim spektakël, një finale që po e pret me padurim edhe Phil Foden. "Gjeja më e rëndësishme ishte fitorja, por ndiej që ndeshja kundër Holandës ishte mbase ndeshja ime më e mirë me fanellën e Anglisë. Jam shumë i lumtur. Finalja kundër Spanjës? Do të thotë shumë. Do të jetë ndeshja më e rëndësishme e karrierës, mezi po e pres këtë ndeshje. Ne besojmë shumë tek aftësitë tona, jemi të vetëdijshëm se Spanja është një skuadër fantastike, mbi të gjitha për mënyrën se si mban topin, por ne e njohim shumë mirë edhe forcën tonë. Kjo ndeshje mund të ndryshojë jetët tona", u shpreh Foden.

Al Ittihad synon katër transferime të mëdha gjatë kësaj vere

Klubi nga Superliga e Arabisë Saudite, Al Ittihad, thuhet se po synon të komplotojë katër nënshkrime të mëdha gjatë afatit kalimtar të verës. Gazetari i "L'Equipe", Loic Tanzi, ka pohuar se skuadra e Superligës Saudite

po kërkon të përfundojë katër marrëveshje të mëdha në këtë afat kalimtar. Ylli i Romës, Houssem Aouar, thuhet se do të transferohet në skuadrën saudite, pasi ka bërë vetëm 25 paraqitje në sezonin e tij të parë

në kryeqytetin italian. Për më tepër, Tanzi pretendon se Al Ittihad është në kontakt me sulmuesin anësor të Aston Villas, Moussa Diaby, qëndërrbrojtësin e Paris Saint-Germain, Marquinhos dhe

mesfushorin e Manchester United, Casemiro. E ardhmja e këtij të fundit në "Old Trafford" është mbuluar me pasiguri pas një sezoni të dytë të vështirë tek Unitedi. Casemiro është raportuar gjerësisht për t'u

larguar nga Unitedi këtë verë, me Superligën e Arabisë Saudite me sa duket një destinacion i mundshëm. Vlen të theksohet se tek Al Ittihad luajnë yje si Karim Benzema, N'Golo Kante, Fabinho dhe Luiz Felipe.

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regjistruar në: 12.07.2024
Nr. br. 3476
Prishtinë - Prishtinë



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 12.07.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK
(Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Operator për Thirrje për Amvisëri, Biznese dhe Shërbim nga Konsumatori" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Drejtoria e Administratës

Numri i Referencës: DA/KJ-10/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIV

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periodha Provuere: 3 muaj

Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- Kontaktin konsumatorët e amvisërisë lidhur me çështjet e ndryshme që kërkojnë nga udhëheqësi;
- Mban shënim për çdo ankesë të konsumatorit dhe i adreson ato pa humbur kohë;
- Kontaktin bizneset me të cilat kompania ka marrëveshje për mbledhjen e mbeturinave dhe adreson pyetjet lidhur me operimin sa më të mirë të kompanisë;
- Pranon thirrje nga amvisëritë dhe bizneset lidhur me pyetje, sugjerimet apo ankesat ndaj kompanisë;
- Adreson ankesat e çdo konsumatori dhe mban shënim për këtë;
- Angazhohet nëse ankesa e konsumatorit është rregulluar dhe e njofton atë;
- Me mirësjellje udhëzon konsumatorët për hapat e mëtejshëm për zgjidhjen e problemit të tyre;
- Përgatit raportet e punës në baza javore, mujore dhe vjetore lidhur me ankesat e konsumatorëve;
- Sipas kërkesës së udhëheqësit apo menaxhmentit harton statistika lidhur me natyrën e ankesave gjatë një periudhe të caktuar;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkojnë nga Udhëheqësi;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë për thirrje dhe kujdesit për konsumatorë "Call Centre"

Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë universitare apo shkollimi i mesëm
- Përvoja e punës e kërkuar:** 3 vite përvojë pune,

Titulli i vendit të Punës: "Zyrtar i Shitjes në Bizneset e Mëdha, Koorporata dhe Institucione" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Drejtoria për Shitje për Biznese

Numri i Referencës: DA/KJ-11/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XI

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periodha Provuere: 3 muaj

Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- Është i përgjegjshëm për organizimin rreth të gjitha detajeve të kontratave;
- Identifikimi dhe negociimi i bizneseve të mëdha, korporatave dhe institucioneve cilat mund të jenë potenciale për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi lidhur me mbledhjen e mbeturinave dhe politikave tjera që bien nën domenin e kompanisë;
- Harton draft kontrata lidhur me bizneset të cilat do të ofrohen shërbimet e pastrimit përfshirë identifikimin e nevojave të kompanisë/biznesit, përcaktimin e specifikimeve për shërbimet e pastrimit, si dhe përcaktimin e çmimeve dhe afateve.
- Në bashkëpunim apo i autorizuar nga udhëheqësi negocion termat dhe kushtet e kontratave me bizneset e interesuara përmes komunikimeve zyrtare si takime zyrtare, e-mail apo kontakt përmes telefonit lidhur me çmimet, afatet, përgjegjësitë dhe të drejtat e secilës palë;
- Harton planin e veprimit lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës apo marrëveshjes;
- Monitoron zbatimin dhe përmbushjen e kontratës nga të dy palët përfshirë kontrollin e zbatimit të kushteve specifike të kontratës, pagesën e çmimit sipas afateve, ofrimin e shërbimeve nga kompania.
- Sigurohet që detyrimet e kontratës të zbatohen në mënyrë të saktë dhe me kohë duke respektuar politikat dhe procedurat e kompanisë;
- Mbanë komunikimin dhe bashkëpunimin me bizneset me të cilat kompania ka lidhur kontratë dhe zgjidhë shqetësimet apo i adreson ato në mënyrë që procesi të mos ndalet.

- Mbanë shënime dhe dokumentimin e plotë të të gjitha aktiviteteve lidhur me kontratat aktive, duke përfshirë komunikimet zyrtare dhe çështjet financiare;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkojnë nga mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i raporton Udhëheqësi i Njesisë për Bizneset e Mëdha, Koorporatave dhe Institucioneve.

Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë universitare
- Përvoja e punës e kërkuar:** 2 vit përvojë pune në fushën përkatëse

Titulli i vendit të Punës: "Zyrtar i Shitjes në Bizneset e Vogla dhe të Mesme" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Drejtoria për Shitje për Biznese

Numri i Referencës: DA/KJ-12/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XI

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periodha Provuere: 3 muaj

Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- Identifikimi dhe negociimi i bizneseve të cilat mund të jenë potenciale për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi lidhur me mbledhjen e mbeturinave dhe politikave tjera që bien nën domenin e kompanisë;
- Harton draft kontrata lidhur me bizneset të cilat do të ofrohen shërbimet e pastrimit përfshirë identifikimin e nevojave të kompanisë/biznesit, përcaktimin e specifikimeve për shërbimet e pastrimit, si dhe përcaktimin e çmimeve dhe afateve.
- Në bashkëpunim apo i autorizuar nga udhëheqësi negocion termat dhe kushtet e kontratave me bizneset e interesuara përmes komunikimeve zyrtare si takime zyrtare, e-mail apo kontakt përmes telefonit lidhur me çmimet, afatet, përgjegjësitë dhe të drejtat e secilës palë;
- Sigurohet që të gjitha pikat e nevojshme të kontratës të jenë të rregullta dhe në përputhje me politikat legislative të kompanisë.
- Pas përfundimit të procesit të hartimit dhe negociimit të kontratave, zyrtari është përgjegjës për finalizimin e marrëveshjes dhe përgatitjes së draftit final për nënshkrimin e kontratës me biznesin e caktuar;
- Monitorimi i kontratave: Zyrtari ka përgjegjësinë për monitorimin e përmbushjes së kontratave nga të dy palët. Kjo mund të përfshijë kontrollin e zbatimit të specifikimeve të kontratës, pagesën e çmimit sipas afateve, kthimin e shërbimeve të paplotësuara dhe zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që mund të lindë ndërmjet palëve.
- Rishikimi dhe rinovimi i kontratave: Zyrtari duhet të marrë përgjegjësinë për rishikimin e kontratave në afat të caktuar dhe të merret me procesin e rinovimit të tyre. Ky proces kërkon analizën e performancës së biznesit të pastrimit, negociimin e çmimeve apo ndryshimeve të tjera në rast të nevojshme, dhe nënshkrimin e kontratës së rinovuar.
- Ky është një shembull i përgjithshëm i detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarit për hartim, negociim dhe nënshkrim të kontratave;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkojnë nga mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i raporton Udhëheqësi i njesisë për bizneset e vogla dhe të Mesme

Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik apo Ekonomik
- Përvoja e punës e kërkuar:** 2 vit përvojë pune profesionale

Kriteret e përgjithshme për praninë në detvrat:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,

- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirushme).
- ✓ Kopje të Letërnjofimit,
- ✓ Vertetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 13.07.2024 deri me datën 27.07.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00 të datës 27.07.2024.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervisitim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejtë njëqind (100) pikë, ku kalushmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 13.07.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistes deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



REGIONALNA KOMPANIJA ZA PROIZVODNJU OTPADA "Pastrimi" SH. A

Na osnovu Zakona br. 03/L-212 o radu, član 8 Administrativno uputstvo FPT br. 01/2024 o regulisanju postupka konkursa u javnom sektoru konkretno član 5 stav 1,2 i član 7, Uredba br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RM "Pastrimi" SH. A, Odluka od 12.07.2024. godine glavnog izvršnog direktora KRM "Pastrimi" SH. A onda, proglasi ga:

Interna konkurencija
(Za završetak radnog mesta)

Radno mesto: "Operater za pozive za kućnu, poslovnu i korisničku službu" u KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozicija,

Odeljenje: Direkcija za administraciju

Referentni broj: DA/KJ-10/2024

Mesečni koeficijent/plata: Nivo XIV

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

Dužnosti i odgovornosti:

- Kontaktira kućne potrošače u vezi sa različitim pitanjima koja je zahtevao lider;
- Vodite evidenciju o žalbama kupaca i obračajte im se bez gubinja vremena.
- Kontaktira preduzeća sa kojima kompanija ima ugovore o prikupljanju otpada i bavi se pitanjima u vezi sa najboljim poslovanjem preduzeća;
- Prima pozive od domaćica i preduzeća u vezi sa pitanjima, sugestijama ili pritužbama protiv kompanije;
- Rešava pritužbe svakog potrošača i prati ovo;
- Uključite se ako je žalba potrošača rešena i o tome je obaveštavate;
- Učtivo navodi potrošače na dalje korake za rešavanje njihovog problema;
- Priprema sedmične, mesečne i godišnje izveštaje o radu koji se odnose na reklamacije kupaca;
- Na zahtev lidera ili rukovodstva, on izlaže statistiku u vezi sa prirodom pritužbi u datom periodu;
- Obavlja radne i druge dužnosti vezane za opis radnih dužnosti koje zahteva Voda;
- Za svoj rad odgovara vodi Jedinice za poziv i brigu o kupcima "Call Centar"

Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Univerzitetska diploma ili srednje školovanje
- Potrebno radno iskustvo:** 3 godine radnog iskustva,

Radno mesto: "Prodavac u velikim preduzećima, korporacijama i institucijama" u KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozicija,

Odeljenje: Direkcija za prodaju preduzeća

Referentni broj: DA/KJ-11/2024

Koeficijent/mesečna plata: Nivo XI

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

Dužnosti i odgovornosti:

- Odgovoran za organizovanje svih detalja ugovora;
- Identifikovanje i pregovaranje velikih preduzeća, korporacija i institucija koje bi mogle da budu potencijal za zaključivanje sporazuma o saradnji vezanih za prikupljanje otpada i druge politike koje spadaju u domen kompanije;
- Izrađuje ugovore vezane za preduzeća kojima će biti ponuđene usluge čišćenja, uključujući identifikaciju potreba preduzeća/preduzeća, određivanje specifikacija za usluge čišćenja i određivanje cena i rokova.
- U saradnji sa ili ovlašćenim od strane lidera pregovara se o odredbama i uslovima ugovora sa zainteresovanim preduzećima putem zvaničnih komunikacija kao što su službeni sastanci, e-mailovi ili telefonski kontakti u vezi sa cenama, rokovima, odgovornostima i pravima svake strane;
- Izrađuje akcioni plan u vezi sa praćenjem ugovora ili implementacijom sporazuma;
- Prati sprovođenje i ispunjenje ugovora od strane obe strane uključujući kontrolu primene specifičnih uslova ugovora, isplatu nagrade u skladu sa rokovima, pružanje usluga od strane preduzeća.
- Obezbediti da se obaveze ugovora izvršavaju tačno i pravovremeno pridržavajući se smernica i procedura preduzeća;
- Komunicirajte i saradujte sa preduzećima sa kojima je preduzeće sklopljeno ugovor i rešava nedoumice ili ih rešava tako da proces ne bude zaustavljen.
- Vodi evidenciju i punu dokumentaciju svih aktivnosti vezanih za aktivne ugovore, uključujući zvanične komunikacije i finansijska pitanja;
- Obavlja poslove i druge dužnosti vezane za opis poslova koje zahteva supervizor;
- Za svoj rad izveštava šefa Jedinice za velika preduzeća, korporacije i institucije.

Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Univerzitetska diploma
- Potrebno radno iskustvo:** 2 godine radnog iskustva u relevantnoj oblasti

Radno mesto: "Prodavac u malim i srednjim preduzećima" u KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozicija,

Odeljenje: Direkcija za prodaju preduzeća

Referentni broj: DA/KJ-12/2024

Koeficijent/mesečna plata: Nivo XI

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

Dužnosti i odgovornosti:

- Identifikovanje i pregovaranje preduzeća koja mogu biti potencijal za zaključivanje sporazuma o saradnji u vezi sa prikupljanjem otpada i drugim politikama koje spadaju u domen kompanije;
- Izrađuje ugovore vezane za preduzeća kojima će biti ponuđene usluge čišćenja, uključujući identifikaciju potreba preduzeća/preduzeća, određivanje specifikacija za usluge čišćenja i određivanje cena i rokova.
- U saradnji sa ili ovlašćenim od strane lidera pregovara se o odredbama i uslovima ugovora sa zainteresovanim preduzećima putem zvaničnih komunikacija kao što su službeni sastanci, e-mailovi ili telefonski kontakti u vezi sa cenama, rokovima, odgovornostima i pravima svake strane;
- Uverite se da su svi neophodni ugovorni poeni fer i u skladu sa zakonodavnom politikom kompanije.
- Nakon zaključenja procesa izrade i pregovaranja ugovora, funkcioner je odgovoran za finalizaciju sporazuma i pripremu konačnog nacrta za potpisivanje ugovora sa dodeljenim preduzećem;
- Praćenje ugovora: Funkcioner ima odgovornost za praćenje ispunjenja ugovora od strane obe strane. To može da podrazumeva kontrolu primene specifikacija ugovora, isplatu nagrade po planu, povraćaj nepotpunih usluga i rešavanje svih sporova koji se mogu pojaviti između strana.
- Pregled i obnavljanje ugovora: Službenik treba da preuzme odgovornost za razmatranje ugovora u datom periodu i bavi se procesom njihovog obnavljanja. Ovaj proces zahteva

analizu poslovnog učinka čišćenja, pregovaračkih cena ili drugih promena u slučaju potrebe i potpisivanja obnovljenog ugovora.

- Ovo je opšti primer dužnosti i odgovornosti zvaničnika za izradu, pregovaranje i potpisivanje ugovora;
- Obavlja poslove i druge dužnosti vezane za opis poslova koje zahteva supervizor;
- Za svoj rad izveštava šefa Jedinice za mala i srednja preduzeća

Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Univerzitetska diploma Pravnog fakulteta ili Ekonomsko radno iskustvo potrebno: 2 godine profesionalnog radnog iskustva

Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ da budem državljanin Republike Kosovo,
- ✓ Da ima punu sposobnost da deluje, u skladu sa zakonom koji je na snazi;
- ✓ Posedovanje najmanje jednog od zvaničnih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Budite u mogućnosti da izvršite odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imate obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i/ili veštine potrebne za radno mesto
- ✓ Uspešno usvojene procedure prijema određene ovim zakonom.

Znanje, veštine i kvaliteti potrebni u postupku regrutacije

- ✓ Sposobnost logičkog rezonovanja i analize;
- ✓ Komunikacione veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost zastupanja.
- ✓ Istraživanje, analitičko, vrednovanje i formulisane preporuke i stručnih saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i vršenja diskrecije po pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Obimno poznavanje terena, metode istraživanja, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

Dokumenti koji će biti dostavljeni u sklopu zahteva i način njihovog podnošenja

- ✓ Prijava završena i potpisana od strane kandidata,
- ✓ Kopija diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove,
- ✓ Kopija uverenja o zaposlenju (Penzion poverenje, sertifikat ili ugovor o radu),
- ✓ Dokazi o obukama i kursovima,
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (Poželjno).
- ✓ Kopije ID-a,
- ✓ Osuđujuća presuda da nije osuđen za krivično delo ne starije od 3 meseca.

Način prijave na konkursu:

Zainteresovani kandidati, zvaničan obrazac možete dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RM "Cleaning" SH.A.
Sve aplikacije moraju da se prave elektronskim putem samo preko elektronske platforme;
punesimi.krmpastrimi@gmail.com

Tačan datum i vreme završetka javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 13.07.2024 do 27.07.2024. Poslednji put prijave su 16:00 dana 27.07.2024.

Sve prijave koje stignu posle isteka roka neće biti u razmatranju.

Način ocenjivanja i kriterijumi ocenjivanja.

Ocenjivanje kandidata se radi na osnovu CV-ja, pismenog testa i intervjuisanja (oralni test).

- ✓ CV kandidata ocenjen je sa do deset (10) poena,
- ✓ Pismeni test se procenjuje do sedamdeset (70) poena,
- ✓ Intervjuita (oralni test) se procenjuje na dvadeset (20) poena.

Postupak procene sadrži stotinu (100) tačaka, gde je pastiš ostvarenje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati biće obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

Približan raspored procedure regrutacije:

Javni konkurs otvoren do 13.07.2024.

Preliminarna faza verifikacije aplikacija do 7 dana,

Pisana test faza do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjuja do 7 dana nakon što su objavljeni pisani rezultati testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon ocenjivanja intervjuja.

Napomena: Neotkrivena, neoskenerana dokumenta i ona koja stignu po isteku roka konkursa neće biti ispitana.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshepeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qëndresa Tara nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Ajete Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Zgjim Dana nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës së Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Qëndresa Tara nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës së Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Ajete Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 të Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Njomza Hajdari shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu "28 Nentori".

- Brodosane Sherif Bajrami shpall te pavlefshme dipllomen Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Masar Masar Ramadani shpall te pavlefshme deftesat e kl VI- IX shfmu "28 Nentori".

- Brodosane Enis Krasniqi shpall te pavlefshme 4 deftesat Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

